



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

KUVENDI I KOMUNËS

01 Nr. 0106/01-24209/2017

Datë. 18.12.2017

PROCESVERBAL

Nga mbledhja Inauguruese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës e mbajtur me dt. 18.12.2017, me fillim në orën 10.00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e kryesoi : Anëtari më i vjetër i Kuvendit në këtë përbërje z. Sadik Hoti .

Në mbledhje marrin pjesë 34 anëtarë të Kuvendit të Komunës: z. Flamur Fetahaj, z. Haxhi Sejdiu, z. Nik Hyseni, z. Jusuf Osmani, z. Shaban Luma, znj. Teuta Pallaska –Milla , znj. Florentina Gjergjaj, znj. Saranda Hyseni, z. Muhamrem Musa , znj. Dijana Qarkagjija, z. Basri Komoni, znj. Hana Zeka , znj. Edi Puka, znj. Drita Buza - Zhaveli, z. Agon Batusha, z. Shpend Komnova , znj. Mimoza Shala , znj. Lirika Komoni , z. Krishnik Alijaj, z. Bekim Jupa , z. Halit Isufi , znj. Dafina Syla, znj. Adelina Shehu-Kola , z. Bashkim Gashaj, z. Bekim Ermeni, z. Sadik Hoti, znj. Saranda Hoda, znj. Besarta Lekaj, z. Anton Shala, z. Zef Komani, znj. Arjeta Gjoklaj, z. Fazli Hoxha, znj. Valentina Alijaj, z. Edmond Dushi.

Mungon : z. Hekuran Dula.

Të pranishëm të tjerë: Kryetari i Komunës z. Ardian Gjini , Ministri z. Pal Lekaj, Deputeti z. Hajdar Beqa, ish Kryetar të Komunës së Gjakovës, përfaqësues të institucioneve lokale dhe Qendrore, përfaqësues të Policisë së Kosovës, përfaqësues Shoqatave të dalura nga Lufta e UÇK-së, të ndërmarrjeve publike, të Mediave të OJQ-ve, të OSBE, përfaqësues të Institucioneve të ndryshme në Komunën e Gjakovës, si dhe qytetar të Komunës së Gjakovës , përfaqësues të ZKKK-së, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të OSBE-së, zyrtarët për informim, zyrtarë të tjerë Komunal, si dhe përfaqësues nga mediat e shkruara dhe elektronike dhe qytetarë të Komunës së Gjakovës.

Kryesuesi i mbledhjes: I nderuar Kryetari i Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini , Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Gjakovës, të nderuar Deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Ministër z. Pal Lekaj, ish Kryetar të Komunës së Gjakovës, përfaqësues të institucioneve lokale dhe Qendrore, përfaqësues të Policisë së Kosovës, përfaqësues Shoqatave të dalura nga Lufta e UÇK-së, të Mediave të OJQ-ve, të OSBE, përfaqësues të Institucioneve të ndryshme në Komunën e Gjakovës, të nderuar të pranishëm.

Sot jemi ftuar në mbledhjen inauguruese të Kuvendit të Komunës së Gjakovës, dhe e shfrytëzojë rastin të uroj anëtarëve të ri të Kuvendit dhe Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini përmarrjen e besimit nga qytetarët e komunës së Gjakovës, përmendat 4 vjeçar, duke ju dëshiruar punë të mbarë dhe suksese përealizimin e synimeve të juaja dhe përbushjen e obligimeve ndaj Qytetarëve.

Duke u mbështetur në nenin 42.5 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës, do të udhëhiqet nga unë, si anëtar më i vjetër i këtij Kuvendi .

Ftesat dhe agjenda e mbledhjes është dërguar me kohë, sipas afateve të parapara ligjore. Konstatohet se në këtë mbledhje janë të pranishëm 34 anëtar, z. Hekuran Dula mungon me arsy, andaj është plotësuar kushti i kuorumi për fillimin e punimeve të kësaj mbledhje solemne, dhe më lejoni të fillojmë me punimet sipas agjendës së paraparë .

Rendi i ditës për mbledhjen inauguruese

10:00-10:15. Arritja dhe nënshkrimi i anëtarë të Kuvendit të Komunës dhe pjesëmarrësve tjerë.

10:15-10:30. Fjalja mirëseardhëse e anëtarit më të vjetër të Kuvendit të Komunës,

10:30-10:45, Kryesimi i mbledhjes nga anëtari më i vjetër i Kuvendit të Komunës.

- Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës
- Dhënia e betimit nga Kryetari i Komunës.

10:45- 11:00, Fjala Përshëndetëse e Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini

11:00-11:15. Pauza

11:15. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Gjakovës

Kryesuesi i Mbledhjes : Fillimi do të bëjmë betimin të gjithë anëtaret e ri të Kuvendit të Komunës.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit, ju ftojë që në harmoni me Nenin 35.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të ngriheni në këmbë dhe të bëjmë betimin solemn për marrjen e mandatit si anëtar të Kuvendit të Komunës së Gjakovës.

Betimin do ta bëjmë duke e lexuar të gjithë njëkohësisht deklaratën e betimit që e keni marrë me materialin e mbledhjes dhe pastaj deklaratat e nënshkruara duhet ti dorëzoni në sekretarinë e kuvendit.

(Unë _____, “**Betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t’i kryej me ndër , besnikëri , pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t’i ushtroj autorizimet e mia si këshilltar i Kuvendit të Komunës së Gjakovës , në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.)**Betohem****

Kryesuesi i mbledhjes: Urime të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës, për marrjen zyrtare të detyrës dhe ju dëshiroj suksese dhe punë të mbarë.

Konstatoj se betimi u bë nga 34 anëtar të Kuvendi që ishin prezent .

Kryesuesi i Mbledhjes : Të nderuar të pranishëm tani e ftojë Kryetarin e zgjedhur të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini, që në harmoni me nenin 57 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të bëjë betimin para anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës.

Kryetari i Komunës z. Ardian Gjini:

Unë, Ardian Gjini “**Betohem (ose deklaroj solemnisht) që do t’i kryej detyrat e mia dhe do t’i ushtroj kompetencat e mia si Kryetar i Komunës së Gjakovës, me ndër, besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që t’i siguroj kushtet për një jetë të qetë për të gjithë”**Betohem**.**

Kryesuesi i Mbledhjes : Urime i Nderuar z. Kryetar për besimin e marrë duke ju dëshiruar suksese në punën tuaj si Kryetar i Komunës së Gjakovës.

Tani e ftoj Kryetarin e Komunës së Gjakovës z. Ardiq Gjini që ta merre një fjalë rasti me rastin e inaugurimit si Kryetar i Komunës së Gjakovës .

Kryetari i Komunës z. Ardiq Gjini: I nderuar z. Kryesues i Mbledhjes të nderuar anëtar të Kuvendit të Komunës së Gjakovës urime për zgjedhjen dhe për betimin e dhënë sot, sepse qytetarët e komunës së Gjakovës ju kanë zgjedhur juve që për 4 vite do të përfaqësoni i interesat e qytetareve, vota e qytetarëve është obligim për secilin prej nesh si dhe një nderim i madhe për të gjithë ne.

Unë ju premtoj se do të bashkëpunoj me secilin nga ju në mënyrë që për këto 4 vite të punojmë sa më shumë dhe ti realizojmë sa më shumë premtimet që i kemi dhënë.

Dua ti falënderoj të gjithë mysafirët tonë të nderuar sepse kjo është një mbledhje solemne dhe prezenca juaj sot këtu e ka ritë edhe më shumë këtë solemnitet.

Një falënderim të veçantë do të bëjë për paraardhësit ish Kryetarët e Komunës së Gjakovës, duke filluar nga z. Mazllom Kumnova i cili ka qenë kryetar në një periudhë të vështirë të pas luftës dhe ka bërë një punë të rëndësishme edhe pse nuk kanë funksionuar institucionet tjera të rëndësishme shtetërore, gjithashtu e falënderoj edhe pse nuk është prezent z. Aqif Shehu i cili ka bërë një punë të mirë për Komunën e Gjakovës dhe ka lënë gjurmë të pashlyeshme në komunën e Gjakovës , E falënderoj jashtëzakonisht shumë kryetarin dhe tani ministrin Pal Lekaj që ka lënë gjurmë të thella në zhvillimin e Gjakovës dhe do të mbahet mend gjatë nëpër gjenerata për angazhimin dhe punën e bërë për Komunën e Gjakovës, e falënderoj edhe znj. Mimoza Kusari Lila e cila ka qeveris me komunën e Gjakovës në rrethana të vështira dhe do të mbahet mend si kryetarja e parë grua në Komunën e Gjakovës .

Unë do të kemi kujdes të veçantë për Bashkëpunimin me opozitën sepse opozita në të gjithë botën synon ti nxjerr në pah të metat e qeverisë me qëllim të fitimit të pushtetit në zgjedhjet e ardhshme , por është e kuptueshme se dështimi i një administratës është në dëm të qytetarëve andaj ne duhet të punojmë bashkërisht edhe me opozitën që të bëjmë punë të mira për qytetarët tanë .

Në 4 vitet e ardhshëm ne do të punojmë me partnerët tanë qeverisës që programi jonë që tani është program i qytetarëve të Komunës së Gjakovës të realizohet, me aktivizimin e të gjithë mekanizmave që kanë rol në rritjen e sigurisë, do të punojmë për rritjen e cilësisë në arsim do ta themelojmë pleqësinë e arsimit, sa i përket shëndetësisë të angazhohemi që të janë të kyçur të gjithë profesionistët e mirë , do të provojmë që bujqësinë ta sjellim në një nivel tjetër me këshillime me subvencione nëpërmes bashkëpunimit edhe me qeverinë qendrore, do të punojmë edhe për Mjedis për Kulturë për Rini për Sport për rekreacion, dhe në të gjitha sferat tjera .

Unë kamë premtuar se për qeverisjen e kaluar do të flas vetëm një dit dhe nuk do të ankohem për dështime duke u justifikuar me atë çka ka ndodhur me qeverisjen e kaluar do të bëjmë çmos që projekti i krenës të realizohet sepse është një projekt që e ndryshon pamjen e Gjakovës, do të punojmë në Parkun e madh ashtu siç është premtuar dhe nuk do të ndërtohet në këtë park por do të jetë parku unik në krejt Kosovën, do ta bëjmë rrugën e Radoniqit në bashkëpunim me KRU Gjakova dhe me Qeverinë Qendrore, do të realizojmë projektin deri tek Maja e Kurorës, do të ndërtojmë dy urat që janë unike në Ballkan, do të punojmë varrezat e Dëshmoreve sepse jemi vonuar shumë dhe do të nisemi menjëherë me këtë projekt, do të bashkëpunojmë me Komunën e Rahovecit për ndërtimin e Pendës së Drinit të Bardhë ku ka qenë dhe do të thirrem edhe tek Qeveria Qendrore , kemi me e punuar për hyrje daljet e qytetit, në vitin 2018 do të filloj qarkorja e Gjakovës dhe kemi punuar edhe këto dit me ministrinë ta lëvizim segmentin e par të Gjakovës nga Skivjani në Qerim që e shkarkon trafikun nga transporti i rëndë, shumë shpejt do të dalim nga ky objekt i Komunës dhe do të shikojmë se çfarë do të mund të bëjmë edhe për rrugën kryesore të Gjakovës, do të realizojmë projektin e ujësjellësit të Rekës, do të ndërtojmë rrugën Kralan- Gërgoc që hapet një zonë e Jashtëzakonshme.

Programi i AAK-së do të jetë programi i harmonizuar me partneret dhe nuk do të ndodhë më që tenderi për pastrimin dimëror të rrugëve të hapet me 27 dhjetor, nuk ka me ndodhë që tenderi për bartjen e nxënësve të hapet në Shtator dhe jam shumë i lumtur që nënshkrinin e parë që do ta bëjë si Kryetar i Komunës është për bartjen e nxënësve deri në shkolla, këto që i fola janë të mundshme por ka ndodhur vetëm për neglizhencë.

Jam i lumtur që sot jam betuar para jush dhe e ndjej peshën e përgjegjësisë si as një herë më parë, në të njëjtën kohë ndihem i nderuar para qytetarëve të Gjakovës që më kanë besuar, andaj edhe një herë urime të gjithëve dhe na prift e mbara .

Kryesuesi i Mbledhjes : Urime z. Kryetar suksese dhe të gjitha të mirat .

Kërkoj nga anëtarët e Kuvendit që deklarata e betimit të nënshkruara ti dorëzoni në sekretarinë e kuvendit, si dhe formularët e deklarimit të pasurisë të cilët ju kemi shpërndarë seçilit duhet ti plotësoni dhe brenda 30 ditëve të dorëzohen në Agjencinë Kundër Korruptionit në Prishtinë ose ti dorëzoni në Sekretarinë e Kuvendit . Të nderuar të pranishëm duke ju falënderuar për pjesëmarrje në këtë takim solemnë të Kuvendit të komunës së Gjakovës fillimisht ju ftojmë që sipas agjendës së paraparë të bëjmë një pauzë prej 15 minutave dhe të kthemë në sallë për vazhdimin e mbledhjes së rregullt dhe të procedojmë me zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Gjakovës .

Pas Pauzës vazhdimi i Mbledhjes .

Kryesuesi i Mbledhjes: Të nderuar anëtar të Kuvendit të Komunës së Gjakovës, po vazhdomë me pikën e rendit të Ditës: Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Gjakovës.

Në Sallë janë të pranishëm 34 anëtarë andaj meqë ekziston Kuorumi po fillojmë me këtë pikë .

Sa i përket kësaj pike nen 41 i Ligjit për vetëqeverisje Lokale, dhe Udhëzimi Administrativ 2009/1 e sqarojnë procedurën e zgjedhjes së Kryesuesit të Kuvendit. Votimi duhet të jetë i fshehtë, sekretaria e kuvendit i ka bërë përgatitjet e duhura për zgjedhjen e kryesuesit .

Andaj fillimisht kërkoj nga anëtaret e Kuvendit që të paraqesin propozimet e tyre për kandidatët për tu zgjedhë Kryesues i Kuvendit, ku secili ka të drejtë të propozoj dhe të jetë i propozuar, andaj ju ftoj që të bëni propozimet për kandidat për kryesues të Kuvendit të Komunës .

Znj. Saranda Hyseni: Përshëndetje për të gjithë, i nderuar kryetar z. Ardiq Gjini urime për detyrën dhe besoj se bashkëpunimi me anëtaret e Kuvendit do të jetë më i mirë i deritanishëm, gjithashtu urime të gjithë anëtarëve të kuvendit dhe uroj një bashkëpunim të mirë.

Propozimi jonë i përbashkët i AAK-së, PDK-së, PSHDK-së, Nismës, për kryesues të Kuvendit të Komunës së Gjakovës është z. Anton Shala.

z. Agon Batusha: I Nderuar kryesues të nderuar Koleg i nderuar Kryetar urime të gjithëve për detyrën. Në emër të Partive opozitare të Alternatives , Vetëvendosjes, LDK-së dhe AKR-së propozojmë z. Edmond Dushi kandidat për Kryesues të Kuvendit .

Kryesuesi i Mbledhjes: Kërkohet që të formohet një komision i votimit dhe i numërimit të votave prej 3 ose 5 anëtarëve i cili do të menaxhoj votimin dhe do të bëjë komunikimin e rezultateve, andaj kërkoj që të paraqitni propozimet e juaja për anëtarët e komisionit ..

- 1 Flamur Fetahaj
- 2 Shpend Kumnova
- 3 Dafina Syla
- 4 Arjeta Gjoklaj
- 5 Drita Buza

Kryesuesi i Mbledhjes : E qes në Votim formimin e komisionit me këtë përbërje : Kush është për, Kundër, abstenim .

Nga Anëtaret e Kuvendit të komunës **unanimisht u votua Por** përbërjes së këtij Komisioni .

Andaj ju ftoj anëtaret e Komisionit që të zëjnë vendet .

z. Bekim Jupa : Kërkoj që në fletëvotimet të jenë të shënuar emrat e dy kandidateve sepse ashtu është e parapara me ligj.

Kryesuesi i Mbledhjes : Duhet të presim pak deri sa Shërbimi Profesional i Kuvendit të na sjell fletëvotimet me emrat e dy kandidatëve .

Tani komisioni do ti ftojë me emra të gjithë anëtarët e Kuvendit një nga një dhe do të votojnë për Kryesues të Kuvendit të Komunës së Gjakovës, dhe pas përfundimit të votimit dhe numërimit të votave në mënyrë të hapur para anëtarëve të Kuvendit njëri nga anëtaret e Komisionit e bënë komunikimin e rezultatit të votimit.

Kryesuesi i Mbledhjes: Pasi përfundoji procesi i votimit dhe i numërimit të votave për kryesues të Kuvendit të Komunës së Gjakovës e ftoj njërin nga anëtarët e Komisionit që të bëjë komunikimin e rezultatit të votimit .

Znj. Dafina Syla: Pas procesit të votimit dhe numërimit të votave në emër të Komisionit të votimit po ju paraqes rezultatin e Votimit, ku z. Anton Shala ka marrë gjithsejtë 20 vota , ndërsa z. Edmond Dushi ka marrë 14 vota, andaj në bazë të këtij rezultati z. Anton Shala është zgjedhur kryesues i Kuvendit të Komunës së Gjakovës urime z. Kryesues.

Kryesuesi i Mbledhjes: Nga rezultati i votave konstatoj se z. Anton Shala është zgjedhur Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gjakovës në këtë mandatë .

Pas procesit të votimit me 20 vota për z. Anton Shala dhe 14 vota për z. Edmond Dushi, Kuvendi i komunës e miratoi këtë :

V E N D I M

1. Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gjakovës zgjidhet z. Anton Shala.


2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e komunës

Kryesuesi i Mbledhjes: Urime z. Kryesues dhe e ftoj që ta zë vendin dhe të merr një fjalë rasti .


Kryesuesi i Kuvendit z. Anton Shala: I nderuar Kryetar i Komunës së Gjakovës z. Ardiq Gjini , të nderuar anëtar të mediave të nderuar Anëtar të Kuvendit të Komunës ju përshëndes të gjithëve dhe ju falënderoj për besimin e dhënë pa dallim, andaj shfrytëzoj rastin të ju uroj për zgjedhjen e juaj anëtar të Kuvendit të Komunës së Gjakovës dhe ju premtoj se do të kemi një bashkëpunim të mirë dhe do të dalim mbi interesat partiake në të mirë të interesit të përgjithshëm. Falënderoj kryesuesin e kësaj mbledhje z. Sadik Hoti për udhëheqjen e kësaj mbledhje .

Meqenëse se në bazë të agjendës së paraparë nuk kemi ndonjë pikë ét rendit të ditës ju uroj edhe një herë të gjithëve dhe na prift e mbara , e shpalli të myllur këtë takim dhe mirë u pafshim në takimin e radhës .

Mbledhja u shpall e myllur në ora 11: 40.

Procesmbajtës

Burim Bajrami



Kryesuesi i Kuvendit

z. Anton Shala